



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 11.12.2015]

Për: Shoqerine "Tower" Shpk me NIPT L21717003H.

Procedura e prokurimit: **“Kerkese per Propozime”** me objekt : **“Mbikqyrje punimesh për rehabilitimin e gjelbërimit anësor dhe hyrje – daljeve në qendrat e banuara në segmentin Levan-Kakavijë”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mbikqyrje punimesh për rehabilitimin e gjelbërimit anësor dhe hyrje – daljeve në qendrat e banuara në segmentin Levan-Kakavijë”.**

Kohëzgjatja: **6 muaj zbatim punimesh dhe 20 muaj garanci, ne total 26 muaj nga data e fillimit te punimeve.**

Fondi limit: **2.840.278 (dy milion e tetëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 16.11.2015.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh: Nr.	Shoqeria	Vlera e ofertes pa tvsh
1	GEOSAT GROUP	2,272,222
2	VLER-INVEST	2,366,000
3	TOWER SHPK	2,383,000
4	"TAULANT" SHPK	2,405,000
5	C.E.C GROUP	2,410,500
6	A & E ENGINEERING sh.p.k	2,500,000

**Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem me arsyet perkatese:
Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Geosat Group” shpk (80%) dhe “A.Sh. Engineering” shpk (20%) per arsye se:**

Bashkimi i shoqerive nuk eshte bere ne perputhje me nenin 74, pika 2, te VKM nr. 914, date 29.12.2014 ku nder te tjera citohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Ne marreveshjen e lidhur para noterit eshte percaktuar vetem perqindja e pjesemarrjes per secilen shoqeri dhe nuk jane percaktuar elementet konkrete te punes qe do te kryeje secili nga anetaret e bashkimit.

Oferta e paraqitur eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar e percaktuar ne nenin 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 704, datë 29.10.2014 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*.

Shoqeria “Geosat Group” shpk nuk ploteson piken 2.1.1 te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit ku kerkohet: *“Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik”*. Ne objektin e aktivitetit te kesaj shoqerie nuk eshte perfshire mbikqyrja e punimeve.

Shoqeria “Geosat Group” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi nuk disponon piken e licenses se kerkuar NP -12. Kjo eshte e vetmja pike license e kerkuar dhe shoqeria “Geosat Group” shpk nuk mund te kryeje 80% te punes pa patur kete license.

Shoqeria “Geosat Group” shpk nuk ploteson piken 2.3.4 te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi si sherbim te ngjashem ka paraqitur nje kontrate mbikqyrje me objekt: *“Supervizion i punimeve te rrugeve “Rehabilitim i segmentit rrethrotullimi i doganes Kashar” dhe “Rikonstrukcion i rruges hyrese te Elbasanit, segmenti fakulteti filologjik – unaze e madhe”*, nderkohe qe kjo kontrate nuk ka perfunduar.

Shoqeria “A.Sh. Engineering” shpk nuk ploteson kushtin per shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve te muajit shtator, detyrim ky i maturuar para dites se tenderit.

Shoqeria "A.Sh. Engineering" shpk nuk ploteson piken e Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit lidhur me punesimin e nje agronomi ose nje inxhinieri pyjesh pasi nuk ka te punesuar me keto kualifikime. Ky specialist eshte i domosdoshem per realizimin e 20% te punes qe ka marre persiper. Shoqeria "A.Sh. Engineering" shpk nuk ploteson piken e Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit lidhur me realizimin e sherbimeve te ngjashme pasi nuk ka paraqitur asnje vërtetim të lëshuar nga një ent publik ku te deshmohet se ka realizuar sherbime te tilla.

Bashkimi i perkohshem i shoqerive "Vler Invest" shpk (40%) dhe "Infratech" shpk (60%) per arsye se:

Prokura e posacme eshte hartuar gabim pasi si administratore e "Vler Invest" shpk rezulton Filiana Veizaj.

Oferta e paraqitur eshte me e ulet se vlere minimale e lejuar e percaktuar ne nenin 7 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 704, datë 29.10.2014 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Shoqeria "Vler Invest" shpk nuk ploteson piken e Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit lidhur me realizimin e sherbimeve te ngjashme pasi ka paraqitur dokumentacion per realizimin e dy sherbimeve te ngjashme: I pari me vlere 194.900 leke dhe i dyti me vlere 237.600 leke, ne total 432.500 leke, nderkohe qe sipas perqindjes se sherbimit qe ka marre persiper te kryeje (40%) i takon te faktoje realizimin e sherbimeve te ngjashme ne shumen 454.444 leke.

Shoqeria "Infratech" shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi nuk disponon piken e licenses se kerkuar NP -12. Kjo eshte e vetmja pike license e kerkuar dhe shoqeria "Infratech" shpk nuk mund te kryeje 60% te punes pa patur kete license.

Shoqeria "Infratech" shpk nuk ploteson piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit ku kerkohet: "Operatori Ekonomik duhet te kete jo me pak se 5 (pese) punonjës te siguruar për çdo muaj për periudhën Janar 2015 – Shtator 2015. Per te vertetuar kete kusht, Operatori Ekonomik duhet te paraqese vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per kete periudhe, i cili duhet te perputhet me liste pagesat e punonjesve për kete periudhe" pasi mungon vertetimi per numrin e punonjesve per muajin shtator 2015.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "Tower" Shpk me NIPT L21717003H, se oferta e paraqitur, me një vlerë **2.383.000 (dy milion e treqind e tetedhete e tre mije)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **03.12.2015**.

Ankesa: Per kete procedure ka paraqitur ankim shoqeria “Geosat Group” shpk ne daten 10.11.2015 lidhur me kerkesat per kualifikim. Ankimi u pranua dhe ne daten 12.11.2015 eshte ngarkuar nje shtojce ne sistem duke shtyre afatin e hapjes se ofertave me pese dite. Me pas nuk jane paraqitur ankimime

